



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Proces-verbal

A. Të dhëna të përgjithshme

Për miratimin e “Planit të Integritetit 2025–2028”, Bashkia Elbasan

Data e takimit: 15.07.2025

Vendi i takimit: Salla Multifunksionale, Bashkia Elbasan

Ora e hapjes së takimit: 10:30

Kryesuesi i takimit: Z. Lutfi Lala, Kryetar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Këshilltarë pjesëmarrës në takim, nr 3

emrat:

Eva Bica

Kejsi Çakani

Sokol Sinani

Anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Çështjet Ligjore

Nr 2

Punonjës të administratës pjesëmarrës në takim, nr 11

Emrat: Ervin Muço, Lorena Haxhiymeri, Edvin Palloshi, Aida Talelli, Ardiola Bajraktari,
Ana Vrioni, Marsida Biba, Nadire Kreka, Elona Kaçi, Ana Vrioni, Enea Sanço

Anëtarë të strukturave komunitare pjesëmarrës në takimi, nr 4

Emrat: Komuniteti Rom dhe Egjiptian

Tjeter Vizion

Media Miranda Sadiku

Artiola Tashi

Pjesëmarrës në takim nga komuniteti: nr 18

Nga te cilet vajza/gra: nr 11

B. Zhvillimi i takimit.

Prezantimi i draft Planit të Integritetit, Bashkia Elbasan

Prezantimi i pyetjeve, çështjeve për të cilat kërkohet opinion i publikut, Kryetari i Grupit të Punës, Z Ervin Muço

Pyetje nga publiku:

1. Organizata Komunitetit Rom dhe Ergjiptian, anëtar i Forumit OGP

Në cilin ligj dhe dokument strategjik bazohet ky plan?

Përgjigje nga punonjësi i Bashkisë, Kryetari i Grupit të Punës: Z. Ervin Muço

Plani bazohet në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKM nr. 241/2018 për politikat e integritetit në sektorin publik, VKM nr. 873/2021 për rregullat e etikës në administratën publike, si dhe Strategjinë Kombëtare Antikorrupsion 2024–2030. Gjithashtu, është në përputhje me parimet e OGP Local për qeverisje të hapur.

2. Organizata Tjeter Vizion, anëtarë i Forumit OGP

Çfarë përfitimesh sjell zbatimi i planit për qytetarët?

Përgjigje e pyetjeve: Koordinator Performances: Lorena Haxhiymeri

- Shërbime më cilësore dhe më transparente;
- Ulje të riskut të korrupsionit dhe shkeljeve etike;
- Pjesëmarrje më e gjerë e qytetarëve në vendimmarrje;
- Besim më i madh te Bashkia si institucion i hapur dhe i përgjegjshëm.

3. Elona Kaçi, sektori i Financës

A do të ketë kosto shtesë zbatimi i planit?

Përgjigje nga punonjësi i Bashkisë: Z. Ervin Muço

Zbatimi do të bëhet kryesisht me burimet ekzistuese të Bashkisë dhe integrim në buxhetet vjetore të drejtorive. Në rast të projekteve të reja, do të përdoren edhe burime të financuara nga donatorë ose partnerë ndërkombëtarë. Nuk parashikohen detyrime të pambuluara buxhetore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

4. Pyetje nga Mediat dhe Komisioni Keshillit Bashkiak

Si do të sigurohet që ky plan të mos mbetet vetëm në letër?

Plani ka tregues të matshëm (KPI) për çdo masë, monitorim tremujor nga Drejtoria e Monitorimit dhe Drejtoria e Integritetit, raportim vjetor te Këshilli Bashkiak dhe publikim online për transparencë.

C. Konkluzionet e takimit Kryetari i Keshillit Bashkiak, Z Lutfi Lala dhe Kryetarit te Grupit të Punës Z.Ervin Muço.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Lutfi Lala, dhe Kryetari I grupit të Punës Z. Ervin Muço, falenderuan anëtarët e Këshillit Bashkiak, Anëtarët e Forumit OGP, Mediat dhe Grupin e Punës për diskutimet dhe vlerësimet e dhëna gjatë shqyrtimit të “Kodit të Sjelljes së Bashkisë Elbasan”.

U theksua se ky dokument përbën një bazë të rëndësishme për forcimin e kulturës së integritetit, etikës dhe profesionalizmit në administratën vendore, duke përcaktuar qartë rregullat e sjelljes, parandalimin e konfliktit të interesit, menaxhimin e dhuratave dhe ruajtjen e komunikimit korrekt me qytetarët.

Z. Lala nënvizoi rëndësinë e monitorimit të zbatimit të Kodit dhe raportimit të rregullt pranë Këshillit Bashkiak, si dhe angazhimin e administratës për organizimin e trajnimeve periodike dhe garantimin e njohjes së detyrueshme të Kodit nga të gjithë punonjësit.

D. Mbyllja e takimit. Ora 12: 30

Sekretari Keshillit Bashkiak

Sokol Sinani